



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.427/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, Fazile Sejdiu, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Fushë Kosovë për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.10.2017 mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHEN** si të pa lejuara ankesat e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, Fazile Sejdiu, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Fushë Kosovë me numër ZL.Anr.427/2017 dhe ZL.A.nr.428/2017 të datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

## A r s y e t i m

PZAP-i më datën 23.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Fazile Sejdiu, kandidate për anëtare e Kuvendit Komunal Fushë Kosovë, nga radhët e subjektit politik PDK me të cilën pretendon se i janë keqpërdorur votat e saj në Qendrën e Votimit(QV) 0901x në Shkollën Filllore “Mihal Grameno” Fushë Kosovë, dhe në Qendrën e Votimit0903e Parashtrësia e ankesës pretendon se në këtë VV vetëm në klasën Nr.6 ku ka votuar familja e saj pesë anëtarshë iu kanë numëruar vetëm 2 vota si dhe votat e miqëve dhe përkrasësve të saj. Kërkon nga Paneli që të bëhet rinumërimi i votave në këtë Qendër Votimi.

Parashtrësia e ankesës ka bashkangjitur Raportin e Komisionit në VVprovë ankesës, ku mendon se i mungojnë votat.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me manipulimin e votave në Qendrat e Votimit të cekur në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliken me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi

shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankueses Fazile Sejdiu, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZLANr.427/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Faton Ademi**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.